

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA RAHOVEC/Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me sekretaren juridike Shemsije Shehu, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. F. nga fshati Q., komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë/Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1004/2016 të datës 17.08.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencën e përfaqësuesit të akuzës Prokurori i Shtetit Bajram Kryeziu, dhe të akuzuarit, më datë 13.03.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A. F. i lindur më datë ..., në fshatin P., komuna e Rahovecit, tani me vendbanim në fshatin Q., komuna e Rahovecit, me nr. personal të letërnjoftimit ..., ku edhe tani jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, kinse më parë i pa dënuar, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Prej datës së pavërtetuar e gjerë me dt. 14.02.2013, në shtëpinë e tij në fshatin Q., komuna e Rahovecit, me qëllim që ti sjellë vetit pasuri në mënyrë të kundërligjshme, në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që njëhsorit elektrik nr.17736229, pllombat shtetore i ka të manipuluar, të hapura dhe prapë të mbyllura, për rreth kapakut nga ana e majtë është futur shiriti filmik, është penguar puna e diskut, në brendi ka pluhur të shiritit filmik, duke penguar kështu regjistrimin e saktë e energjisë së shpenzuar elektrike. I njejtë është Recedivist për shka se përsëri më datë 201.10.2014, është konstatuar se jashtë njëhsorit elektrik përmes kabllor është lidhur direkt në rrjetin elektrik, duke penguar – anashkaluar regjistrimin e energjis elektrike të shpenzuar, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të Distriktit në Gjakovë, me rastin e kontrollit dhe kalibrimit të Divizionit të Rrjetit në Prishtinë, me ç'rast të dëmtuarës KEDS – Distrikti në Gjakovë, i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 483.35 €.

Me këtë ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 4, 6, 7, 17, 41, 42, 49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52 dhe 73 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale, të njëjtit i shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Gjykon me dënim me gjobë në shumën prej dy qind (200) euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej nëntë dhjetë (90) ditëve, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afat prej një (1) viti, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

E dëmtuara KEDS-Distrikti në Gjakovë, udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej tridhjetë (30) euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë/Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1004/2016 të datës 17.08.2016, kundër të akuzuarit A. F. nga fshati Q., komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datën 13.03.2018, ku ka qenë prezent përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Bajram Kryeziu, i akuzuari, ndërsa nuk ka qenë prezent i autorizuari i të dëmtuarës edhe pse gjykata ka prova se i njejtë ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, ka qëndruar në tersi pranë aktakuzës, ku i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se ndihet fajtor dhe ndin keqardhje për rastin që ka ndodhur.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë që të pranojë ose të mos e pranojë fajësinë dhe pasi i akuzuari e ka pranuar fajësinë, gjykata e ka njoftuar lidhje me efektet e pranimit të fajësisë. Po ashtu është kërkuar edhe mendimi i Prokurorit të Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili ka deklaruar se është i pajtimit me pranimin e fajësisë.

Andaj nga të lartëcekurat, pasi që janë plotësuar kushtet e parapara sipas dispozitave të nenit 248 par.4 të KPRK-së, për shkak se i akuzuari në fillim të seancës fillestare është deklarua i fajshëm, në tërësi e ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet, gjykata nuk ka proceduar administrimin e provave.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari, ka gjetur se i njëjti ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së dhe gjendjen e tillë faktike e mori ashtu sikur ishte përcaktuar në aktakuzë dhe provat për të cilat i përmban aktakuza e të cilat janë: shikimi i procesverbalit mbi konstatimin e gjendjes faktike në kalabrim me nr. 57/11 të dt. 11.06.2013; procesverbalit mbi konstatimin e gjendjes faktike me numër 1351209 të dt.20.10.2014, fatura mbi dëmin e shkaktuar DGJ15HPO4031 i dt. 22.10.2014; të lëshuar nga Sektori i faturimit – KEDS, Divizioni i furnizimit në Gjakovë, foto-dokumentacioni si dhe shkresat e tjera që gjenden në lëndë, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale me të cilën akuzohet, andaj gjykata ka vendosur të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit.

Me rastin e caktimit dhe matjes së dënimit gjykata ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sips nenit 73 dhe 74 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka marrë sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim, i njejtë është deklaruar i fajshëm, si dhe i vjen keq për rastin që ka ndodhur, ndërsa rrethana veqanërisht rënduese

nuk gjeti, andaj të njejtit ia ka shqiptuar dënimin me kusht me shpresë dhe bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës që kërkesë pasurore – juridike të realizojë në procedurë të rregullt juridiko civile bazohet në nenin 463 të KPPK-së

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësorë bazohet në nenin 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 të KPPK-së

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr.284/2016 me datë 13.03.2018

Sekr.juridike
Shemsije Shehu

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mizahir Shabani

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.